

# **TË DREJTAT KULTURORE**

*Deklarata e Friburgut*

*Të drejtat kulturore, Deklarata e Friburgut, faqja 2*

<i>marrja në konsideratë</i>	arsyetimi
<b>1</b> <i>parimet themelore</i>	parimet dhe përkufizimet
<b>2</b> <i>përkufizimet</i>	
<b>3</b> <i>identiteti dhe trashëgimia kulturore</i>	të drejtat kulturore
<b>4</b> <i>referencat e komuniteteve kulturore</i>	
<b>5</b> <i>ndërhyrja dhe pjesëmarrja në jetën kulturore</i>	
<b>6</b> <i>edukimi dhe formimi</i>	
<b>7</b> <i>informacioni dhe komunikimi</i>	
<b>8</b> <i>bashkëpunimi kulturor</i>	
<b>9</b> <i>parime të qeverisjes demokratike</i>	zbatimi
<b>10</b> <i>integrimi në ekonomi</i>	
<b>11</b> <i>përgjegjësia e aktorëve publik</i>	
<b>12</b> <i>përgjegjësia e Organizatave ndërkombëtare</i>	

## **TË DREJTAT KULTURORE**

### **Deklarata e Friburgut**

(1) *Duke kujtuar* Deklaratën Universale e të Drejtave të Njeriut, dy paktet ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara, Deklaratën universale të UNESCO-s mbi diversitetin kulturor dhe strumentet e tjera universale dhe rajonale përkatëse;

(2) *Duke ripohuar* që të drejtat e njeriut janë universale, të pandara dhe të ndërvarura, dhe që të drejtat kulturore janë njëlloj të barabarta me të drejtat e tjera të njeriut si një shprehje dhe një kërkesë e dinjitetit njerëzor;

(3) *Të bindur* që shkeljet e të drejtave kulturore provokojnë tensione dhe konflikte të identitetit, të cilat janë një prej shkaqeve themelore të dhunës, të luftës dhe të terrorizmit;

(4) *Të bindur*, gjithashtu, që diversiteti kulturor nuk mund të jetë në të vërtetë i mbrojtur pa realizimin efektiv të të drejtave kulturore;

(5) *Duke konsideruar* nevojën për të marrë parasysh dimensionin kulturor e të gjitha të drejtave të njeriut aktualisht të njohura;

(6) *Duke kujtuar* që respekti i diversitetit dhe i të drejtave kulturore duhet të jetë një faktor vendimtar për legjitimitetin dhe koherencën e zhvillimit të qëndrueshëm, që themelohet mbi pandarshmërinë e të drejtave të njeriut;

(7) *Duke vertetuar* që të drejtat kulturore kanë qënë të deklaruara kryesisht në kontekstin e të drejtave të minoriteteve dhe të popujve autoktonë dhe se është e domosdoshme të garantohen në mënyrë universale, veçanërisht për personat më të pafavorizuar;

(8) *Duke konsideruar* që një qartësim i vendit që zënë të drejtat kulturore në kuadrin e sistemit të të drejtave të njeriut, ashtu si edhe një kuptim më të qartë të naturës dhe pasojave të shkeljes së tyre, janë mënyra më e mirë për të mos lejuar që mund të përdoren në

favor të një relativizmi kulturor, ose si një arsye për të nxitur komunitetet, ose popujt njëri kundër tjetrit;

*(9) Vlerësojmë* që të drejtat kulturore të përmendura në këtë Deklaratë janë aktualisht të njohura edhe pse të shpërndara, nga një numër i konsiderueshëm strumentesh në lidhje me të drejtat e njeriut, dhe ajo që është e rëndësishme është ti bashkojmë për ti vënë në dukje, për të konstatuar dhe favorizuar dobinë e tyre;

paraqesim këtë Deklaratë të të drejtave kulturore aktorëve të tre sektorëve, publik (Shteteve dhe institucioneve të tyre), civil (Organizatave joqeveritare dhe shoqatave dhe institucioneve të tjerave jo fitimprurëse) dhe privatë (bizneset), për të favorizuar njohjen dhe zbatimin e tyre në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe universal.

### **Artikulli 1** *(parimet themelore)*

Të drejtat e përmendura në këtë Deklaratë janë esenciale për dinjitetin njerëzor; për këtë arsye ato bëjnë pjesë përbërëse të të drejtave të njeriut dhe duhet të jenë interpretuar sipas parimeve universale të pandarshmërisë dhe të ndërvarësisë. Si rrjedhim:

**a.** këto të drejta janë garantuar pa diskriminim, të bazuara në veçanti mbi ngjyrën, seksin, moshën, gjuhën, fenë, bindjen, prejardhjen, origjinën e kombit ose të etnisë, origjinën ose kushtet sociale, vendlindjen apo çdo situatë tjetër ku basohet formimi i identitetit kulturor i personit;

**b.** asnjë person nuk duhet të vuaj apo të jetë i diskriminuar në asnjë mënyrë nëse ushtron, ose nuk ushtron, të drejtat që shpallen në këtë Deklaratë;

**c.** asnjë person nuk mund të marrë si shkak këto të drejta për të shkelur një tjetër të drejtë të njohur në Deklaratën universale ose në strumente të tjerë të lidhura me të drejtat e njeriut;

**d.** ushtrimi i këtyre të drejtave mund t'ju nënshtrohet vetëm limiteve të parashikuara në strumentet ndërkombëtare lidhur me të

drejtat e njeriut; asnjë dispozitë e kësaj Deklarate nuk mund të çënoj të drejtat që përkojnë me legjislacionin dhe praktikën e një Shteti ose të të drejtës ndërkombëtare;

e. zbatimi efektiv i të drejtës së njeriut nënkupton konsiderimin e përshtatmërisë së saj kulturore, si pjesë e parimeve themelore të renditura më sipër.

## **Artikulli 2** *(përkufizime)*

Për qëllimet e kësaj deklarate,

a. termi “kulturë” përfshin vlerat, besimin, bindjet, dijet dhe artet, traditat, institucionet dhe mënyrën e jetesës, me të cilat një person ose një grup shpreh njërezimin e tij dhe i jep domëthenie eksistencës dhe zhvillimit të tij;

b. shprehja “identitet kulturor” është përkufizuar si një bashkësi referimesh kulturore prej secilës një person, i vetëm apo në komunitet, përkufizohet, komunikon dhe synon të njihet në këtë dinjitet;

c. për “komunitet kulturor”, në përkufizojmë një grup personash që ndajnë referenca përbërse të një identiteti kulturor të përbashkët, që synojnë ti ruajnë dhe ti zhvillojnë ato.

## **Artikulli 3** *(identiteti dhe trashëgimia kulturore)*

Çdo person, i vetëm apo në komunitet, ka të drejtën:

a. të zgjedh dhe të shikoj të respektuar identitetin e tij kulturor në larminë e mënyrave të tij të të shprehurit; kjo e drejtë ushtrohet në veçanti me të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes, të fesë, të opinionit edhe të shprehjes;

b. të njoh dhe të shikoj të respektuar kulturën e tij ashtu si edhe kulturat që, në larminë e tyre, përbëjnë trashëgiminë e përbashkët të njerëzimit; kjo nënkupton veçanërisht të drejtën e njohjes të të

drejtave të njeriut edhe të lirive themelore, vlerat bazë të kësaj trashëgimie;

c të marrë pjesë, duke përfshirë dhe ushtrimin e të drejtave të edukimit edhe të informimit, në trashëgimitë kulturore që janë shprehje e kulturave të ndryshme dhe burime për brezat e ardhshëm.

#### **Artikulli 4** *(referencat e komuniteteve kulturore)*

a. Çdo person ka lirinë të zgjedh për tu identifikuar apo jo në një apo në më shumë komunitete kulturore, pa marrë parasysh kufi, dhe të ndryshoj zgjedhjen e tij;

b. Askujt nuk mund ti imponohet një identitet apo të asimilohet në një komunitet kulturor pa dëshirën e tij.

#### **Artikulli 5** *(ndërhyrja dhe pjesëmarrja në jetën kulturore)*

a. Çdo person, i vetëm apo në komunitet, ka të drejtën të ndërhyj dhe të marrë pjesë lirisht, pa marrë parasysh kufi, në jetën kulturore nëpërmjet aktiviteteve të zgjedhura prej tij.

b. Kjo e drejtë përfshin veçanërisht:

- lirinë e të shprehurit, në publik apo privatisht, në gjuhën apo në gjuhët e zgjedhura prej tij;
- lirinë e ushtrimit, në marrëveshje me të drejtat e njohura në këtë deklaratë, praktikat e tij kulturore dhe të ndjek një mënyrë jetese të lidhur me vlerat e burimeve kulturore të tij, veçanërisht në fushën e përdorimit, të prodhimit edhe të shpërndarjes të të mirave dhe të shërbimeve;
- lirinë për të zhvilluar dhe ndarë bashkë njohuritë, shprehjet kulturore, për të udhëhequr kërkime dhe të marrë pjesë në forma të ndryshme të krijimit si edhe në përfitimet që rrjedhin prej tyre;

- të drejtën e mbrojtjes së interesit moral dhe material të lidhura me veprat që janë fryt i aktiviteteve të tij kulturore.

### **Artikulli 6** *(edukimi dhe formimi)*

Në kuadrin e përgjithshëm të të drejtës së edukimit çdo person, i vetëm apo në komunitet, ka të drejtën, përgjatë gjithë ekzistencës së tij, të një edukimi dhe të një formimi që, duke iu përgjigjur nevojave edukative themelore, ndihmojnë në lirinë dhe në zhvillimin e plotë të identitetit kulturor në respekt të drejtave të tjerëve dhe të larmisë kulturore; kjo e drejtë përfshin në veçanti:

- a. njohjen dhe mësimin e të drejtave të njeriut;
- b. lirinë e dhënies edhe marrjes së mësimin në gjuhën e tyre apo në gjuhë të tjera, të njëjtë me një dije që ka të bëjë me kulturën e tij edhe me kulturat e tjera;
- c. lirinë e prindërve të garantojnë edukimin moral edhe fetar të fëmijëve të tyre në përputhje me bindjet që ata kanë në respekt të lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë, që i është njohur fëmijës sipas kapacitetit të tij;
- d. lirinë të krijoj, të drejtoj dhe të marrë pjesë në institucione edukative jo vetëm në atë publik, me kusht që normat dhe parimet ndërkombëtare të njohura në fushën e edukimit të jenë respektuar dhe që këto institucione të jenë në përputhje me rregullat minimale të përshkruara nga Shteti.

### **Artikulli 7** *(komunikimi dhe informimi)*

Në kuadrin e përgjithshëm e të drejtës të lirisë së shprehjes, përfshirë atë artistike, të lirisë së opinionit dhe të informacionit, dhe të respektit të larmisë kulturore, çdo person i vetëm apo në komunitet më të tjerët, ka të drejtën e informacionit të lirë dhe pluralistë që ndihmon në zhvillimin e plotë të identitetit të tij kulturor; kjo e drejtë ushtrohet pa marrë parasysh kufijtë dhe përfshin pikërisht:

- a. lirinë për të kërkuar, për të marrë edhe për të përçuar informacione;
- b. të drejtën e pjesëmarrjes në një informacion pluralistë, në gjuhën apo gjuhët e zgjedhura, për të ndihmuar në prodhimin apo në shpërndarjen nëpërmjet të gjitha teknologjive të informacionit dhe të komunikimit;
- c. të drejtën për t'iu përgjigjur informacioneve të gabuara mbi kulturën, në respekt të të drejtave të përmendura në këtë Deklaratë.

**Artikulli 8** *(bashkëpunimi kulturor)*

Çdo person, i vetëm apo në komunitet, ka të drejtën të marrë pjesë sipas procedurave demokratike:

- në zhvillimin kulturor të komunitetit ku ai bën pjesë;
- në përpunimin, në zbatimin dhe në vlerësimin e vendimeve që i përkasin dhe që ndikojnë në ushtrimin e të drejtës kulturore;
- në zhvillimin e bashkëpunimit kulturor në nivelet e ndryshme të tij.

**Artikulli 9** *(parime të qeverisjes demokratike)*

Respekti, mbrojtja dhe zbatimi i të drejtave të përmendura në këtë Deklaratë përfshin detyrime për çdo person dhe për çdo kolektiv; aktorët kulturor të tre sektorëve, publik, privat dhe civil, kanë pikërisht, përgjegjësinë në quadrin e një qeverisje demokratike, për të bashkëvepruar dhe nëse nevojitet të marrin iniciativën për:

- a. për tu kujdesur dhe për të siguruar respektimin e të drejtave kulturore dhe të zhvillojnë mënyra konsultimi dhe pjesëmarrjeje për të siguruar realizimin e tyre , veçanërisht për personat që kanë më shumë nevojë duke marrë parasysh kushtet e tyre sociale apo përkatësinë e tyre në një grup minoritetesh;



- b.** të siguroar ushtrimin interaktiv të të drejtës së një informacioni të plotë, në mënyrë që të drejtat kulturore të jenë konsideruar prej të gjithë aktorëve në jetën sociale, ekonomike dhe politike;
- c.** të formuar personelin e tyre dhe të sensibilizojnë publikun në mirëkuptimin dhe respektin e të gjitha të drejtave të njeriut dhe veçanërisht të drejtat kulturore;
- d.** të identifikuar dhe mbajtur parasysh dimensionin kulturor në të gjitha të drejtat e njeriut për të pasuruar universalitetin me larminë e tyre dhe të favorizojë përkatësinë e këtyre të drejtave për çdo person, vetëm apo në komunitet.

**Artikulli 10** *(integrimi në ekonomi)*

Aktorët publik, privat dhe civil duhet, në quadrin e kompetencave dhe përgjegjësive specifike:

- a.** të kujdesen dhe të sigurojnë derisa të mirat dhe shërbimet kulturore, përmbajnë vlera, të identitetit dhe të sensit si dhe të gjitha të mirat e tjera në proporcion me ndikimin e tyre domethënës në mënyrën e jetesës dhe shprehjeve të tjera kulturore, janë nënkuptuar, prodhuar dhe përdorur në mënyrë të tillë që të mos çenojnë të drejtat e përmendura në këtë Deklaratë;
- b.** të konsiderojnë që përputhja kulturore e të mirave dhe shërbimeve është shpesh përcaktuese për personat në situatë jo të favorshme për shkak të varfërisë së tyre, të izolimit apo të përkatësisë brenda një grupi të diskriminuar.

**Artikulli 11** *(përgjegjësia e aktorëve publik)*

Shtetet dhe aktorët e ndryshëm publik duhet, në kuadrin e kompetencave dhe përgjegjësive të tyre specifike:

- a.** të përfshijnë në legjislacionet e tyre dhe në praktikatat e tyre kombëtare të drejtat e njohura në këtë Deklaratë;

- b.** të respektojnë, të mbrojnë dhe të realizojnë të drejtat e përmëndura në këtë Deklaratë në kushte të barabarta edhe ti kushtohen në maksimum burimeve që kanë në dispozicion për të siguruar ushtrimin e plotë të tyre;
- c.** të garantojnë për çdo person që i referohet, i vetëm apo në komunitet, shkeljeve të të drejtave kulturore, të cilat kanë një përdorim efektiv dhe, mbi të gjitha, gjyqësor;
- d.** të përforcojnë strumentet e bashkëpunimit ndërkombëtar të nevojshme për zbatimin dhe intensifikimin e bashkëveprimit në kuadrin kompetentë të organizatave ndërkombëtare.

**Artikulli 12** *(përgjegjësia e Organizatave ndërkombëtare)*

Organizatave ndërkombëtare, në kuadrin e kompetencave dhe përgjegjësive të tyre specifike, duhet:

- a.** të garantojnë, në aktivitetet e tyre të përgjithshme, konsiderimin sistematik të të drejtave kulturore dhe të dimensionit kulturor në të gjitha të drejtat e tjera të njeriut ;
- b.** të kujdesen për angazhimin e tyre ,në mënyrë të vazhdueshme, me të gjitha strumentet përkatëse dhe mekanizmat e tyre të kontrollit;
- c.** të kontribuojnë në zhvillimin e mekanizmave të përbashkët të vlerësimit dhe të kontrollit transparent dhe frytdhenës.

I miratuar në Friburg, më 7 maj 2007

**Grupi i punës**, i ashtuquajtur “Grupi i Friburgut”, i përgjegjshëm për redaktimin është i përbërë sot nga:

Taïeb Baccouche, Instituti arab i të drejtave të njeriut dhe Universitetit të Tunit; Mylène Bidault, Universiteti i Parisit X dhe i Gjenevës; Marco Borghi, Universiteti i Friburgut; Claude Dalbera, konsulente, Ouagadougou; Emmanuel Decaux, Universiteti i Parisit II; Mireille Delmas-Marty, Kolegji i Francës, Paris; Yvonne Donders, Universiteti i Amsterdamit; Alfred Fernandez, Oidel, Gjenevë; Pierre Imbert, ish drejtor i të drejtave të Njeriut të këshillit të Europës, Strasburg; Jean-Bernard Marie, CNRS, Universiteti i R. Schuman, Strasburg; Patrice Meyer-Bisch, Universiteti i Friburgut; Abdoulaye Sow, Universiteti i Nouakchott; Victor Topanou, Katedra UNESCO, Universiteti i Abomey Calavi, Cotonou.

Edhe, të tjerë vëzhgues dhe analistë kanë dhënë kontributin e tyre për përgatitjen e këtij testi.

**Lista e personave dhe institucioneve që kanë sponsorizuar deri tani këtë Deklaratë gjendet në sitin e *Observatorit të diversitetit dhe të drejtave kulturore*:**

<http://www.unifr.ch/iiedh/fr/recherches/cultural>

**Kjo Deklaratë i drejtohet të gjithë atyre që, në formë personale apo institucionale, dëshirojnë të marrin pjesë.**

Mund të dërgoni një letër apo një mesazh elektronik antarësie , më të dhënat tuaja personale, ku specifikoni nëse doni të antarësoheni personalisht apo në formë institucionale në:

*Institut interdisciplinaire d'éthique et des droits de l'homme,*

*Av. Beauregard 13, CH 1700 FRIBOURG – [iiedh@unifr.ch](mailto:iiedh@unifr.ch)*

Informacione të tjera, komente, dokumente sinteze, dokumente të punës dhe të programit të kërkimeve janë të disponueshme në sitin e Observatorit.

## **Pse një deklaratë e të drejtave kulturore?**

Në momentin që strumentet normative lidhur me të drejtat e njeriut janë shumëfishuar, pa pasur gjithmonë një coherencë midis tyre, është momenti i duhur për të propozuar një test të tillë. Por, përballë vazhdimësisë së shkeljeve, faktit që luftrat aktuale dhe potenciale mbështeten në dhunimet e të drejtave kulturore, dhe shumica e strategjive të zhvillimit kanë qënë të papërshtatshme pikërisht sepse kanë injoruar këto të drejta, ne konstatojmë që universaliteti dhe pandarshmëria e të drejtave të njeriut ndjejnë gjithmonë e më shumë një marginalizim të të drejtave kulturore.

Zhvillimet e kohëve të fundit të mbrojtjes së diversitetit kulturor nuk mund të jenë kuptuar, nën dënimin e relativizmit, pa inkuadrimin në bashkësinë e pandarshmërisë dhe të ndërvarësise të të drejtave të njeriut.

Kjo Deklaratë mbledh edhe shpjegon të drejtat që janë tashmë të njohura, edhe pse të shpërndara, në shumë strumente. Një qartësim është i nevojshëm për të treguar rëndësinë vendimtare të të drejtave kulturore ashtu si edhe të dimensionit kulturor të të drejtave të tjera të njeriut.

Teksti i ofruar është një version i ri, tërësisht i rishikuar i një projekti të përgatitur për UNESCO-n<sup>1</sup> nga grupi i punës ndërkombëtar pak nga pak i quajtur “Grupi i Friburgut”, sepse është organizuar nga Istituti ndërdisiplinar i etikës dhe i të drejtave të njeriut të Universitetit të Friburgut, në Svicër. Kjo Deklaratë, fryt i një debati të gjatë me aktorë të origjinave dhe kushteve shumë të ndryshme, i është besuar njërëzve, komuniteteve, institucioneve dhe organizatave që kanë për qëllim të marrin pjesë në zhvillimin e të drejtave, lirive dhe përgjegjësive të përmëndura në Deklaratën e mësipërme.

---

<sup>1</sup> *Të drejtat kulturore. Projekti i deklaratës.* P. Meyer-Bisch (éd), 1998, Paris/ Fribourg, Unesco, /Botime universitaire.